

## NJOFTIM PUNËSIMI

### Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK

Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rogozhinë dhe Krujë.

Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: Operator Faturimi pranë Shitjes në Njësinë Operative Kavajë nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri zbaton me përpikmëri procedurat standarde të operimit për leximin dhe faturimin

### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Në zonat e faturimit që nuk mbulohen nga aparatet e leximit (PDA):
  - a.Përgatit listat e leximeve duke verifikuar ndryshimet që mund të kenë ndodhur në listën e konsumatorëve.
  - b.Përcjell listat e leximeve tek Përgjegjësi i Leximit.
  - c.Ndjek plotësimin e listave të leximit duke u siguruar për grumbullimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga Shoqëria.
  - d.Grumbullon listat e plotësuara të leximeve dhe verifikon paraprakisht plotësimin e tyre sipas kërkesave dhe procedurave të Shoqërisë.
  - e.Hedh leximet në sistemin e faturimit
- Në zonat e faturimit që mbulohen nga aparatet e leximit (PDA), kryen verifikimin e leximit të ujëmatësit në sistem dhe klasifikimin e tyre sipas kategorive përkatëse.
- Në rast të evidentimit të gabimeve në lexim ose hedhje/transmetim të dhënash në sistemin e faturimit, para mbylljes së periudhës së faturimit, kryen korrigjimet përkatëse në sistem me miratimin e Përgjegjësit të Faturimit në NjO duke e dokumentuar rregullisht në procesverbal. Këto procesverbale ja dërgon për dijëni Sektorit të

	<p>Faturimit në Drejtorinë e Përgjithshme para mbylljes së periudhës së faturimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në rastet kur mungon leximi, përlllogarit dhe hedh në sistem leximin në bazë të konsumit mesatar të klientit sipas procedurave standarde të operimit.</li> <li>• Mban kontakt me lexuesin për problematika të ndryshme që lindin gjatë procesit të leximit.</li> <li>• Kryen verifikime paraprake për anomalitë tipike si rritje/ulje domethënëse e konsumit, konsum zero, matës i palexuar, etj. dhe ndjek problematikat rast pas rasti me lexuesin</li> </ul>
<p><b>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksperienca pune të mëparshme.</li> <li>• Librezë e Punës</li> <li>• Certifikatë Familjare</li> <li>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës</li> <li>• Dy fotografi</li> <li>• Fotokopje e Diplomës me listën e notave e noterizuar</li> <li>• Dëshmi Penaliteti</li> <li>• Raporti Mjekësor</li> <li>• Vërtetim Vendbanimi</li> </ul>
<p><b>Kushtet e punës:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.</li> <li>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 22.06.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.</li> </ul>	